



BULETINI TREMUJOR
NR 53 - VITI XIV - TM1 2021

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS

TRUSTORJA

PERFORMANCA

PERIUDHA	1 MUAJ	3 MUAJ	VITI AKTUAL	3 VJET	5 VJET	NGA THEMELIMI
REZULTATI	1.98%	1.49%	1.49%	10.11%	19.53%	57.95%
BENÇMARKU*	0.37%	1.60%	1.60%	5.27%	6.94%	41.32%

* INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT SIKURSE I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

LËVIZJET MUJORE

	ÇMIMI I AKSIONIT	KTHIMI BRUTO (mln)	KTHIMI NETO (mln)
JANAR	(0.06%)	(€0.44)	(€1.12)
SHKURT	(0.43%)	(€8.09)	(€8.70)
MARS	1.98%	€40.23	€39.56
TREMUJORI	1.49%	€31.69	€29.74

KONTRIBUIMI

	KONTRIBUTE TË REJA (mln)	LLOGARI TË REJA	LLOGARI AKTIVE
JANAR	€18.90	2,170	392,194
SHKURT	€10.87	2,526	267,937
MARS	€22.16	2,960	293,530
TREMUJORI	€51.93	7,656	317,887*

*mesatarja tremujore

PENSIONIMET

TË PENSIONUAR	SHUMA E TËRHEQUR (mln)	ARSYET			
		PENSION MOSHE	RASTE VDEKJESH	TË TJERA	
JANAR	661	€4.24	362	186	76
SHKURT	533	€3.51	370	101	62
MARS	778*	€5.92	570	186	113
TREMUJORI	1,972*	€13.67*	1,302	419	251*

*Në këto shifra nuk përfshihen tërheqjet për 10% si në numër (prej 28,657) edhe në vlerë (prej 12.02 milionë euro)

PËRMBLEDHJE E FAKTEVE KYÇE

	TM1 2021	TM4 2020
ÇMIMI I AKSIONIT	€1.5795	€1.5564
MJETET NETO NËN MENAXHIM	€2,044,031,855.66	€1,988,073,030.7
TARIFA INVESTUESE	€1,638,368.1	€1,742,472.2
TARIFA OPERACIONALE	€322,708.9	€343,214.2
INVESTIMET NË KOSOVË	€582,008,304	€ 580,611,913
INVESTIMET JASHTË	€1,446,157,256	€1,352,161,519
TË PAINVESTUARA (NË BQK)	€18,244,412	€57,905,959
LLOGARI NË eTRUSTI GJITHSEJ	260,922	255,903
SHËRBIMET E OFRUARA NGA FKPK	18,029	90,733

PLASMANET DHE PERFORMANCA

MENAXHUESI FONDI BANKA BROKERI	NUMRI ISIN / LLOJI I INVESTIMIT	PLASMANET FUNDI TM1	KTHIMI BRUTO NË INVESTIME
Vanguard GSIF	IE00B03HD316	€236,764,157	€3,144,039.99
Nordea 1-SRF	LU0539147214	€349,152,167	€12,248,009.72
Nordea 1-GSEF	LU0257969260	€79,944,882	€5,999,620.20
BNY Mellon RRF	IE00B504KX99	€365,870,044	€7,896,806.08
AXA GILB	LU0227145629	€49,624,987	(€4,616,517.64)
Amundi 3M	FR0007038138	€70,158,756	(€204,124.07)
BNP Parvest DD	LU0102035119	€48,899,079	(€331,648.62)
iShares Edge S&P 500 MinVol	IE00BYX8XD24	€9,520,717	€377,075.99
iShares Edge MSCI Europe	IE00B86MWN23	€12,759,889	€427,086.47
Invesco QQQ UCITS	US46090E1038	€61,750,269	€2,533,716.34
Amundi MSCI Eu Qual Fact	LU1681041890	€60,539,080	€1,042,252.53
SP OilGas Expl ETF	US78468R5569	€20,159,399	(€325,562.36)
LG eCom Logist ETF	IE00BF0M6N54	€35,367,969	€347,942.29
FirstT CybrSec ETF	US33734X8469	€35,552,697	€355,150.33
US Oil ETF	US91232N2071	€10,093,164	(€96,106.93)
Thesari i Kosovës ¹⁾	Obligacione të KS	€461,550,524	€2,495,483.75
Banka në Kosovë ¹⁾	Depozita me afat në KS	€120,457,780	€434,593.20
BQK - të gatshme	Të painvestuara	€18,244,412	(€36,912.25)
GJITHSEJ		€2,046,409,973	€31,690,905.02

¹⁾ Këto janë investime me afat të caktuar maturimi.

LAJME

APLIKIMI PËR TËRHEQJEN E 10%-SHIT U MBYLL MË 6 PRILL 2021

Sikurse e kishim bërë të ditur dy herë para mbarimit të afatit, procesi për tërheqjen e 10%-shit nga të gjithë kontribuuesit e FKPK-së është mbyllur më 6 prill 2021. Ky afat ishte i bazuar në ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike (Nr. 07/L-016, Neni 12A, pika 2), ku përcaktohet që mundësia për aplikim përfundon brenda 4-muajve nga data e hyrjes së këtij ligji në fuqi. Ndërsa hyrja në fuqi e tij, siç është parashikuar në Nenin 17, është në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Publikimi i ligjit në Gazetën Zyrtare ishte bërë më 7 dhjetor 2020, andaj afati 4-mujor përfundoi më 6 prill 2021. Ndërkohë që tashmë janë kryer të gjitha pagesat e këtij procesi.

Kujtojmë këtu se për tërheqjen e 10%-shit për këto katër muaj janë shpague 427,363 kontribuues me një shumë totale të tërheqjes prej 198.06 milionë euro. Në mesatare kontribuuesit kanë tërhequr nga 463 euro dhe fitimi mesatar për të gjitha llogaritë ishte 24.2%.

FILLOI SHPËRNDARJA E PASQYRAVE VJETORE

Në ciklin e vitit 2020 u janë dërguar kontribuuesve 583,200 pasqyra, nga cilat 407,118 me e-mail dhe 176,082 me postë. Këtë vit numri i llogarive të reja u shtua për rreth 37 mijë, por njëkohësisht numri i përdoruesve të shërbimit eTrusti është rritur për rreth 129 mijë, si dhe janë siguruar një numër i madh i adresave të e-mailit, duke bërë të mundur dërgimin e lehtë dhe të shpejtë të pasqyrave përmes internetit. Nga kjo listë e dërgimit vjetor përjashtohen pasqyrat e llogarimbajtësve që nuk kanë pasur asnjë transaksion në tri vjetët e fundit (të tilla ishin 52,811 raste). Edhe për ata që kemi mungesë të adresave të vlefshme (që ishin 22,138) nuk mund të dërgonim pasqyra as këtë vit. Për shkak të pensionimit (ose vdekjes) së kontribuuesve 5,029 llogari janë "tërhequr" rishtazi gjatë 2020. Total i llogarive me tërheqje të përhershme arriti në 56,784. Pasqyrat e llogarisë nuk dërgohen as për këtë kategori të llogarimbajtësve.

RRETH 32 MLN EURO KTHIMI NGA INVESTIMET GJATË TM1 2021

Përkundër luhatjeve më të theksuara në këtë fillimviti, FKPK-ja e përmbylli edhe këtë tremujor me kthim pozitive nga investimet. Bruto ishte 31.1 mln euro kthimi nga investimet e bëra këtë tremujor. Kjo ndikoi që çmimi i njësisë në fund të kësaj periudhe të jetë për 1.49% më i lartë sesa fundin e tremujorit paraprak. Në performancën e investimeve vazhdon të kontribuojnë bindshëm më shumë investimet në tregjet financiare ndërkombëtare. Këtë tremujor investimet jashtë Kosovës kontribuan me 91% të kthimit nga investimet dhe rreth 9% ishte kontribute i investimeve në Kosovë. Investimet në tregjet financiare përbënin rreth 71% të të gjitha investimeve të FKPK-së, kurse rreth 29% ishin investimet në Kosovë. Kujtojmë se në Kosovë të vetmet mundësi investimi aktualisht janë letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe depozitat bankare.

STATISTIKA PËR TËRHEQJEN E 10%-SHIT (11 dhjetor - 6 prill 2021)

Shënim: Meqë afati për aplikim për tërheqjen e 10%-shit është mbyllur më 6 prill 2021, në vijim po i prezantojmë në dhënat në total për gjithë periudhën e aplikimit, meqë ndarja eventuale me tremujor, për vetëm 6 ditë të muajit prill që i takojnë TM2-shit, nxjerr të dhëna krejt të parëndësishme.

SHUMA E APLIKIMIT	NR. PERSONAVE	VLERA E TËRHEQUR	PERSONA TË MUNDSHËM	% E TË MUNDSHMËVE
DERI €10	11,149	€62,878	40,582	11.2%
€11 DERI €50	61,126	€1,775,102	1,145,745	45.2%
€51 DERI €100	55,777	€4,107,527	2,651,281	69.2%
€101 DERI €200	72,643	€10,574,201	6,826,202	82.1%
€201 DERI €500	100,821	€32,456,359	20,957,175	91.8%
€501 DERI €1,000	71,175	€52,765,291	34,085,008	97.5%
€1,001 DERI €2,000	41,779	€55,444,377	35,803,884	95.3%
€2,001 DERI €4,000	10,766	€28,984,889	18,710,681	93.1%
MBI €4,000	2,135	€11,781,891	7,603,882	93.1%
GJITHSEJ	427,371	€197,952,516	644,582	66.3%



PUBLIKON:

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës

Prill 2021

AUTOR:

Jeton Demi

ADRESA:

Rr. "Agim Ramadani" #182-184 10000

Prishtinë, Kosovë

E-MAIL & UEB

info@trusti.org | www.trusti.org



TrustiPensional